



Në bazë të nenit 7, alineja 9 të Ligjit për themelimin të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Maqedonisë nr. 72/2007, 5/2009, 43/2014, 39/16 dhe 164/18), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural shpall

**THIRRJE PUBLIKE nr. 07/2018**

**për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2018**

**I. LËNDA E SHPALLJES**

Lëndë e kësaj shpalljeje është ndarja e përkrahjes financiare për masat në vijim:

Grupi i masave	Emri i masës	Vlera maksimale e shumës së përkrahjes së shpenzimeve të pranueshme (deri më)
Masa 124	Investime në infrastrukturë për zhvillim të bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujarëve për:	
	Infrastruktura për qasje deri tek toka bujqësore	Deri më 1.000.000,00 denarë

**II. TË DREJTË PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE**

Të drejtë për shfrytëzimin e mjeteve kanë subjektet në vijim:

Subjektet	Masa
Njësitë e vetëqeverisjes lokale	124

**III. SHUMA E PËRKRAHJES FINANCIARE**

Përkrahja financiare paguhet sipas parimit të financimit të investimeve përfundimtare nga ana e shfrytëzuesit në shumë prej 100% të vlerës së shpenzimeve të lejuara të pranueshme për investimin. Mjetet nga përkrahja financiare me kërkesë të shfrytëzuesit mund të ndahen në dy kështe ose në pajtim me fazat e realizimit të investimit në bazë të situatave kohore nga mbikëqyrja ose dokumentacioni për furnizim të pajisjes.

**IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI DUHET TË DORËZOHET**

Kërkesat parashtrihen në kopje origjinale

Një kërkesë mund të parashtrijë më së shumti 3 kërkesa të veçanta për masa të ndryshme duke marrë parasysh të gjitha masat nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2018.

Kushtet të cilat duhet të plotësojnë kërkesit e mjeteve janë përcaktuar me:

- Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2018 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 16/18, 100/18, 127/18 dhe 172/18)
- Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13, 177/14, 25/15, 73/15, 83/15, 154/15, 11/16, 53/16, 120/16, 163/16, 74/17 dhe 83/18)
- Rregulloren për kushtet më të përafërta plotësuese për mbështetje të masave për zhvillim rural, shpenzime të pranueshme dhe shkalla e përkrahjes për shpenzimet e pranueshme për shfrytëzues për masë të veçantë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/11, 80/13, 72/14, 88/15, 35/16, 59/16 dhe 178/18),
- Rregulloren për kriteret më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve për masë për zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/11, 80/13, 35/16, 101/17 dhe 162/18),

Kërkesit të cilët kanë plotësuar kushtet për shfrytëzim të mjeteve për masën 124 klasifikohen me pikë të përcaktuar në Rregulloren për kriteret më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve të masave për zhvillim rural.

- Kërkesat me numër të njëjtë të pikëve do të klasifikohen sipas datës dhe kohës së parashtrimit të kërkesës
- Kërkesit nuk kanë të drejtë të fillojnë me realizimin e investimit para nënshkrimit të Marrëveshjes për bashkëfinancim me Agjencinë.

**V. MARRJA E FORMULAREVE DHE UDHËZIMEVE**

Formularët "Kërkesë për përkrahje financiare" me listën e dokumenteve të nevojshme mund të merret në ueb faqen e Agjencisë [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk).

Formularët e lartpërmendur mund të merren edhe drejtpërdrejtë në Agjenci çdo ditë pune prej ora 8:30 deri në ora 16:30 në adresën:

**Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,**  
**Bul. "3-ta Makedonska Brigada" nr. 20**  
**(ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C)**  
**1000 Shkup**

**VI. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE**

Kërkesat e plotësuara për pagesë të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2018 së bashku me tërë dokumentacionin e nevojshëm dorëzohen në gjuhën maqedonase në zarf të mbyllur në të cilin në anën e parme në këndin e epërm të majtë qëndron shenja "MOS HAP", për Thirrjen publike numër 07/2018 dhe theksim të shifrës së masës për të cilën parashtrihet kërkesa. Kërkesa mund të parashtrihet përmes postës ose personalisht në sportelin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për arrije jo në kohë ose të pakompletuar në sportel ose për hapje të parakohshme të kërkesës.

**Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është 17.11.2017. Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren parasysh.**

**Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren parasysh.**

Kontakt:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për lejim të projekteve.

Telefoni **02 3097 - 460**, çdo ditë pune prej ora 08.30 deri në ora 16.30

E-mail: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk)



AGJENCIA PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL